

News

Industria e MEM-: Kompensimi i inflacionit në pagat minimale falë KKP

Kontrata Kolektive e Punës në Industrinë e MEM (KKP MEM) parasheh, që pagat minimale gjithmonë në bazë të indeksit të inflacionit në tetor të përshtaten në zhvillimet e çmimeve. Me 31 tetor indeksi vendor në çmimet e konsumit shënoi një inflacion prej 3.0 %, për çka pagat minimale prej 1 janarit 2023 do të rriten për këtë përqindje. Pagat efektive të punonjësve të veçantë në industrinë e MEM do të negociohen me të gjitha ndërmarrjet veç e veç e me ç' rast pagat minimale duhet detyrimisht të respektohen. Unia për negociatat e pagave të ndërmarrjeve kërkon kompensim të inflacionit për të gjitha pagat, si dhe një rritje reale të pagave, të cilat paraqesin përmirësime për punonjësit.

Shpëtimi i vendeve të punës tek BAT

Të punësuarit (90 % e punonjësve) të British American Tobacco (BAT) në Boncourt (JU) ka ngarkuar sindikatën Unia dhe Syna për përfaqësimin e interesave të tyre. Delegacioni i personelit dhe sindikatave janë takuar me drejtorinë e BAT dhe kanë formuluar pritjet e tyre mbështetur me ligjet e parashkruara mbi procedurën konsultative. Pas bisedimeve të gjata palët gjetën një kompromis të kënaqur. Në javët e ardhshme duhet të përpunohen me përparësi alternativat për ruajtjen e vendeve të punës. Përfundimet e procedurës konsultative në fund do ti prezantohen drejtorisë së BAT dhe qeverisë jurasiane, ashtu si parashohin rregullat ligjore.

Propozimi ligjor për të drejta të barabarta tek bashkimi familjar shkon në konsultim

Shtetasit zviceran nuk duhet të diskriminohen edhe më tej me rastin e bashkimit familjar në raport me shtetasit e BE-së dhe EFTA-s. Propozim ligji i Komisionit të senatit përfshin të gjithë fëmijët e zviceranëve dhe të bashkëshortëve të tyre deri në moshën 21 vjeç apo edhe më të moshuar, si dhe familjarët e afërm të tyre dhe të bashkëshortëve të tyre në vijën ngritëse të afërsisë familjare. Parakusht është mbulimi i harxhimeve jetësore të tyre. Në harmonizim me lëvizjen e lirë të personave dhe mallrave duhet pos tjerash të jetë i siguruar edhe banimi adekuat. Komisioni i senatit ka aprovuar propozimin ligjor në mbledhje e tij të 1 shtatorit 2022 me 17 vota për dhe 7 kundër dhe e ka dërguar në konsultim, i cili zgjatit deri me 9 dhjetor 2022.

Aksioni i madh i infermierisë – të ndalet eksodi i infermiereve

Edhe një vit pas aprovimit të nismës infermiere edhe më tej rreth 300 infermiere në muaj po largohen nga profesioni. Për të ndaluar eksodin e infermiereve me 26 nëntor 2022 në sheshin federal në Bernë u zhvillua një aksion i madh i infermiereve. Pjesëmarrësit me këtë rast kërkuar 5 masa konkrete: **Pagat/Koha e punës:** Rritje të dukshme page tek punësimi i njëjtë, gjegjësisht reduktim i kohës së punës tek paga e njëjtë; **Shtesat:** rritje masive e shtesave të tanishme dhe kreditë kohor si dhe futje të shtesave në rast të ndryshimeve afatshkurtër të planit të shërbimit; **Pushimet vjetore:** Së paku 5 javë deri në moshën 49, 6 javë nga moshja 50, 7 javë nga moshja 70 vjeç; **Regjistrimi faktik dhe pagimi i kohës së punës;** p.sh. përfshirë kohën e zhveshjes, koha e rrugëtimit nga një shërbim në tjetrin tek Spitex-i; **Kujdesi i fëmijëve:** Subvencione për kujdesin e fëmijëve jashtë familjes.

**Pagat e vjeshtës 2022****Shumica e të punësuarve marrin kompensimin e inflacionit**

Kompensimi i inflacionit dominon bisedimet për pagat mes partnerëve social. Sindikatat kërkojnë kompensimin e plotë të inflacionit – dhe për këtë, në parim, hasin në mirëkuptim.

Daniel Lampart, përgjegjës për ekonomi në Bashkimin e Sindikatave të Zvicrës

Vendimet e sektorëve përgjegjës në Unia sipas Bashkimit të Sindikatave të Zvicrës (SGB/USS) tregojnë këtë pamje: Në sektorin e pastrimit të Zvicrës gjermane punëdhënësit dhe sindikatat janë pajtuar për kompensimin prej 3% të inflacionit. Industria e orëve në përgjithësi do të paguan 3.5% kompensim inflacioni. Të punësuarit me paga nën 4372 franga do të marrin më shumë.

Priten edhe bisedime tjera të shumta pagash

Në sektorët tjerë, si industria, pritet të zhvillohen bisedimet për pagat. Sindikatat janë bërë gati për bisedime të vështira, por optimiste. Fjala është për sektorë , të cilët kanë fituar mirë në gjysmën e parë të vitit, thotë Daniel Lampart: «Shini raportet vjetore të bizneseve. Gjithandej qëndron një 'përmbyllje shumë e mirë' apo 'përmbyllje e shkëlqyeshme'. Paratë janë këtu, tani duhet vetëm që edhe punëmarrësit të kenë pjesën e tyre.

Shoqata e punëdhënësve kundër kompensimit automatik të inflacionit

Shoqata e punëdhënësve nisët nga ajo, se mesatarisht 2% do të ishte e mundshme, pasi ndërmarrjet duhet të përballen me pa-siguri. Këtë, Daniel Lampart nga Bashkimi i sindikatave e sheh ndryshe: «Andaj ne duhet të synojmë që në përgjithësi i gjithë inflacioni përsëri të kompensohet» thotë ai. Sidoqoftë paraprakisht dihet se: Një shumicë e të punësuarve në Zvicër me 2023 do të merre kompensimin e inflacionit.

Të zemëruar, të vendosur dhe luftarak**15 000 punëtorë ndërtimtarie kanë ndërprerë punën**

Gjithsejtë 15 000 punëtorë ndërtimtarie, në shenjë proteste kundër planeve të Shoqatës së sipërmarrësve të ndërtimit për të përkeqësuar kushtet e punës, kanë ndërprerë punën. Fillimisht në Tiçino, pastaj në Zvicrën veriperëndimore, në vijim për dy ditë në Zvicrën franceze dhe në përfundim edhe nëpër regjionet e Zvicrës gjermane. Në ditën e 5-të vala e protestës arriti edhe selinë e Shoqatës së sipërmarrësve të ndërtimit në Cyrih.

Hilmi Gashi

Në fund të vitit skadon Kontrata Kombëtare e Punës në ndërtimtarinë kryesore (KKP). Që nga shkurti janë duke u zhvilluar bisedimet me Shoqatën zvicerane të sipërmarrësve të ndërtimit. Mirëpo, nuk ka zgjidhje në horizont. Sipërmarrësit radikal kërkojnë ditë të zgjatura pune deri në 12 orë, më pak të drejta për punëtorët e ndërtimtarisë dhe shkurtime pagash për punonjësit e moshuar. Jo me ne, thonë punëtorët e ndërtimtarisë dhe në 5 ditë proteste ndërprejnë punën duke dalë edhe në rrugë. Dita e 5-të e protestës e punëtorëve të ndërtimtarisë arriti selinë qendrore të Shoqatës së sipërmarrësve të ndërtimit në Cyrih. Me këtë rast ra në sy: shumë punëtorë të ri ndërtimtarie morën pjesë dhe kontribuan që tradita sindikaliste në ndërtimtarinë të arrijë edhe gjeneratat e reja. Presioni i shtuar në rritje rrezikon shëndetin e punëtorëve të ndërtimtarisë gjithnjë e më shumë dhe gjithmonë e më shumë profesionistë janë duke u larguar nga sektori. Megjithatë, sipërmarrësit e ndërtimit me kërkesat e tyre përpiqen të rrisin presionin, në dëm të punëtorëve të ndërtimtarisë dhe të sektorit. Me këtë rast realiteti kërkon masa krejtësisht tjera. Punëtorëve të ndërtimtarisë un nevojitet më shumë mbrojtje, e jo më shumë presion! Nevojiten ditë më të shkurta pune në vend se më të gjata dhe koha e udhëtimit nga magazina deri tek kantieri i punës duhet përfundimisht të kompensohet plotësisht.

Sipërmarrësit e ndërtimit flasin për fleksibilitet

Kërkesat e tyre reduktuese, që fshihen pas fjalës fleksibilitet, duan që punëtorët e ndërtimtarisë ti blejnë përmes një rritje page. Nico Lutz, përgjegjësi i ndërtimtarisë në Unia, shprehet: «Punëtorët e ndërtimtarisë nuk lejojnë të shantazhohen. Rritja e pagave, shkaku i inflacionit, u takon edhe ashtu punëtorëve të ndërtimtarisë.» Dhe ai plotëson më tej: «Kjo manovër e ngathët i zemëron punëtorët e ndërtimtarisë. Marrë parasysh situatën e mirë ekonomike në sektorin e ndërtimit rritja e pagave reale është më se e vonuar.»

Dakordim në raundin e fundit të negociatave

Presioni i bërë nga punëtorët e ndërtimtarisë dha rezultat: më 28 nëntor, në raundin e fundit të negociatave, sindikatat dhe shoqata e sipërmarrësve të ndërtimit arritën një marrëveshje. Kur ne jemi duke bërë gati Horizontin, anëtarët e organizatave nënshkruese ende nuk e kanë dhënë miratimin e tyre për këtë marrëveshje. Megjithatë, tashmë është pozitiv fakti, që është arritur një marrëveshje. U ra dakord që numri i orëve vjetore të punës dhe orëve javore të punës të mbeten të njëjta, por do të ketë një mënyrë të re të rregullimit të orarit të punës. KKP-ja e re do të jetë e vlefshme për tre vjet, me orët e numëruara nga 1 maji deri më 30 prill të vitit të ardhshëm. Dhe, gjithashtu është krijuar një grup për t'u marrë me çështjet e shëndetit dhe sigurisë në vendin e punës. Lufta për kushte të mira pune dhe solidaritet mes punonjësve ia vlen!



Falë angazhimit luftarak sigurohen paga dhe kushte me të mira pune për punëtorët e ndërtimtarisë.

Sesioni i të rinjve 2022

Dëshira për të politizuar duket sheshit

Procedurë e njëtrajtshme e natyralizimit, informacione më të mira për popullatën mbi dhurimin e organeve dhe një reformë të shtyllës së dytë të përkujdesjes në pleqëri, janë disa nga kërkesat, të cilat të rinjtë në kuadër të sesionit federal 2022 do t'ia dorëzojnë kryetares së Parlamentit nacional Irène Kälin.

Hilmi Gashi

Pas edicioneve speciale për pandeminë dhe përvjetorin e viteve të fundit, sesioni rinor i 2022-ës punoi sërish në formën e provuar dhe të testuar në një gamë të gjerë temash. Ekspertët nga organizata të ndryshme si dhe parlamentarë mbështesin pjesëmarrësit për zhvillimin e peticioneve dhe ideve projektuese, të cilat janë konkrete dhe të zbatueshme.

Mënjanim i arbitraritetit tek natyralizimi

Për temën e natyralizimit dhe migracionit u shtruan njëherit dy kërkesa: Së pari procedurat e natyralizimit përfundimisht duhet të jenë të projektuar si të njëtrajtshme dhe objektive, për të evituar vendimet arbitrare. Së dyti të rinjtë propozojnë një integrim më të mirë të refugjatëve në tregun e punës.

Edhe në temën e dhurimit të organeve të rinjtë identifikuan nevojën për veprim dhe i dhanë përparësi nevojave për informacion të popullatës. Në një peticion tjetër sesioni i të rinjve 2022 kërkoi mënjanimin e subvencioneve të dëmshme për biodiversitetin të Zvicrës. Këto janë disa nga kërkesat, të cilat u vendosën nga plenumi dhe që në orët e fundit të sesionit të dielën iu dorëzuan presidentes së Parlamentit nacional Irène Kälin.

Ata munden dhe duan

Të 200 të rinjtë me kërkesat e tyre bënë të qartë, që e kuptojnë aktivitetin politik, që mund të informohen dhe debatojnë dhe që marrin përsipër përgjegjësi për shoqërinë tonë. Pjesëmarrësit e moshës mesatare 17-vjeçe edhe njëherë tjetër dëshmuar vullnetin dhe aftësinë e tyre, për të participuar dhe për të jetuar qytetarinë – nga rruga e deri në pallatin federal.



Pamje nga punimet e sesionit të rinjve në Parlamentin nacional të Zvicrës

25 Nëntor: Kundër dhunës ndaj grave

Ta luftojmë së bashku dhunën strukturore

Në kuadër të 25 nëntorit, ditës ndërkombëtare kundër dhunës ndaj grave, ne duam të tematizojmë dhunën strukturore, pasi dhuna ndaj grave shpesh nuk ndërlihet me raportin shoqëror të forcave dhe diskriminimit.

Emine Sariaslan

Dhuna strukturore përfshinë struktura dhe kushtet shoqërore, ekonomike apo kulturore, të cilat disfavorizojnë individët apo grupet e personave. Këtu hyjnë të gjitha format e diskriminimit, sikur ndarja e pabarabartë e të ardhurave dhe resurseve, mundësitë arsimore dhe pritjet jetësore. Dhuna strukturore pengon individët që të zhvillojnë plotësisht potencialin dhe mundësitë e tyre.

Diskriminimi i shumëfishtë tek migrantet

Dhuna strukturore nuk prek të gjitha gratë në masë të njëjtë. Fjala bie, gratë me histori migracioni janë në masë më të lartë të pre-

kura nga dhuna strukturore, nga njëra anë për shkak të varësive dhe diskriminimit të lidhur me statusin e migracionit, në anën tjetër shkak të përkatësisë gjinore. Ato për arsye të diskriminimit të shumëfishtë përjetojnë në masë më të madhe edhe dhunë strukturore. Ato fitojnë më pak se sa zvicranet. Ato punojnë në kushte më të pasigurta pune. Shpesh diplomat e tyre të prura nga atdheu nuk njihen. Ato i nënshtrohen diskriminimit. Ndërlidhja e dhunës së drejtpërdrejtë me dhunën strukturore shihet edhe tek dhuna në familje. Kështu shumë gra shkak të të ardhurave të ulëta shpesh janë shumë të varura financiarisht nga burrat dhe ndoshta për këtë arsye mbesin gjatë

në marrëdhënie dhune. Lejet e qëndrimit të shumë grave me një histori migracioni është e varur nga burrat e tyre. Pas divorcit, mund të humbasin lejen e tyre të qëndrimit dhe bile edhe të dëbohen. Andaj shumë migrante edhe përkundër dhunës në familje nuk guxojnë të ndahen. Ky diskriminim i shumëfishtë kufizon qasjen e migrantëve në resurset shoqërore (p.sh. të drejtat, arsimi, vetëvendosja etj.) dhe përballet edhe me pasoja të shumta psikike.

Për të luftuar dhunën ndaj grave, nevojitet barazia e vërtetë e të gjitha gjinive dhe ndarje e barabartë e resurseve, ligje kundër diskriminimit.

Intervista me Emine Sariaslan



Dita ndërkombëtare e migrantëve

Çdo vit më 18 dhjetor festohet dita ndërkombëtare e migrantëve, e cila është përcaktuar si e tillë në vitin 2000 nga Kombet e Bashkuara, në shenjë kujtimi për aprovimin e konventës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve migrantë dhe familjeve të tyre. Me këtë rast duhet theksuar se asnjë nga shtetet e BE/EFTA nuk e kanë ratifikuar këtë konventë. Sa e rëndësishme është kjo ditë, kemi pyetur Emine Sariaslan, migrante, ish asambliste e qytetit të Bernës dhe anëtare komiteti drejtues të sindikatës Unia.

Emine, sa është e rëndësishme dita ndërkombëtare e migrantëve?

Një ditë e festuar ndërkombëtare mund të sensibilizojë shoqërinë për të kuptuar rëndësinë e migracionit. Kjo na krijon mundësinë për të biseduar publikisht për problemet dhe shanset e migracionit. Mjerisht, kjo ditë nuk perceptohet mjaftueshëm nga opinioni publik.

Ti shoqëron një kohë të gjatë problemet e migrantëve në Zvicër. Si e sheh ti zhvillimin?

Në Zvicër kam përjetuar zhvillim pozitiv si dhe edhe ngecje. Ne kemi arritur disa përmirësime në botën e punës, si fjalë bie heqja e statusit të sezonierëve apo paga më të mira dhe krijimin e kushteve më të mira pune. Në anën tjetër ka gjithnjë e më shumë pasiguri përkitazi me të drejtën e qëndrimit. Nëse humbet vendi i punës rrezikohet edhe humbja e lejes së qëndrimit. Kështu migrantët janë të detyruar të punojnë në kushte të përkeqësuar pune, vetëm për të mos humbur lejen e qëndrimit. Njëkohësisht punëdhënësit po provojnë të punësojnë vetëm pjesërisht migrantët. E gjithë kjo qon në dumping pagash dhe tendosje sociale. Në fund humbin të gjithë punëmarrësit.

Ku es sheh ti rolin e sindikatave?

Problemi edhe tek sindikatat është jo mjaftueshëm i vetëdijshëm. Edhe kur shumica e anëtarëve kanë sfond migracioni. Kjo temë edhe brenda sindikates nuk është mjaft prezentë. Sindikatat në kuadër të tyre do të duhej të merrnin më seriozisht këtë ditë. Ndoshta me aksione sindikaliste shoqërisë do të duhej ti tërhiqej vëmendja më shumë për këtë temë. Të drejtat e migrantëve janë të drejta njerëzore dhe duhet të perceptohen si të tilla dhe të zbatohen. Këtë ndërgjegje duhet të kultivojnë edhe vet migrantët.

Dhe si duket e ardhmja?

Ne kemi përjetuar prurje, se për të drejta të caktuara është dashur të zhvillohet luftë e ashpër. Nganjëherë rruga është e gjatë, ashtu si ne e kemi parë tek të drejtat e grave. Në anën tjetër të arriturat e deritashme shpesh sulmohen dhe për këtë shkak duhet të mbrohen. Ne duhet të ushtrojmë presion karshi politikës, për tu bërë një shoqëri e drejtë dhe solidare. Për këtë diskriminimi i migrantëve duhet të mënjanohet tërësisht. Me 18 dhjetor duhet përçarur një mesazh të qartë: Barazia e migrantëve nuk duhet të përmbajë vetëm detyrime, por edhe të drejtat që u takojnë!

Marek Wieruszewski

Format e dhunës ndaj grave mund të jenë:

Femicidi: vrasja e grave dhe vajzave shkak të gjinisë

Dhuna seksuale: ngacmimi me fjalë, fishkëllima, prekja, uzurpimi, dhunimi

Dhuna fizike: rrahja, lëndimi

Dhuna psikike: gjuhë urrejtjeje në internet, kërcënime, poshtërime, përndjekje

Dhuna ekonomike: ndalimi i punësimit, heqja e pagave, pabarazia në paga, varfëria (në pleqëri)

Dhuna sociale: kufizimi i mjedisit social, mbyllja e burgimi

Dhuna shoqërore: gjykimimi dhe vlerësimi i një njeriu shkak të gjinisë, reduktimi i njeriut në bazë të rolit dhe stereotipit gjinor

Dhuna strukturore: disfavorizimi në profesion, diskriminimi, gjuha mediave, politika, sporti

Ju pyesni, Unia përgjigjet

Përgjegjësia: A mund të zbresë shefi dëmin nga paga?

Shefi im mi ka zbritur 200 franga nga paga, shkak se grupi i mysafirëve, të cilët unë i kam shërbyer si kamerier, nuk i kanë paguar pijet e tyre. Pasi mysafirët mbi një orë e gjysmë kanë pritur ushqimin e tyre të porositur, janë larguar nga lokali pa paguar fare. Unë nuk jam i vetëdijshëm për fajin tim, pasi që grupin e kam përkujdesur dhe ngushëlluar disa herë. A guxon për këtë arsye shefi im thjeshtë të mi zbresë paratë nga paga?

Myriam Muff: Jo. Përgjegjësia e punëmarrësit është e rregulluar në nenin 321 të së drejtës obliguese. Ajo mbështetet në katër shtylla, të cilat duhet të vijnë në shprehje, për të ardhur fare në pyetje përgjegjësi:

1. dëshmia e lëndimit të kontratës (nga ana e punëmarrësit),
2. dëshmia e dëmit,
3. lidhshmëria mes lëndimit të kontratës dhe dëmit
4. si dhe fajti i punëmarrësit (sjellja e pakujdesshme apo e qëllimshme e punëmarrësit)

Në rastin konkret punëdhënësi juaj nuk mund të dëshmoi, që grupi i mysafirëve është larguar nga restoranti, shkakun se ju keni lënduar detyrimet që lidhen me ligjin e punës. Shefit tuaj nuk i lejohet që t'u zbres nga paga pijet e papaguara.

(Work, 4.11.22)

Kontributet e AHV/AVS: Zbritja nga paga edhe tek jomadhorët?

Unë jam 17 vjeç, ja, gjimnazist dhe gjatë pushimeve pastroi objektin shkollor, për të fituar paratë e mija të gjepit. Më është thënë, se për këtë do të marrë nga 17 franga në orë. A do të më zbriten nga këto kontributet për AHV/AVS dhe arkë pensionale



Përmirësimi i parave të gjepit: Kontributet në AHV/AVS dhe në Arkën Pensionale duhet të paguhen vetëm kur arrihet moshë madhore. (Foto: Jugend-job-börse-bern)

David Aeby: Jo. Detyrimi i AHV/AVS fillon me 1 janar pas mbushjes së moshës 17 vjeçe. Pra, përgjatë vitit vijues nuk do të kesh zbritje për AHV/AVS. Nëse do të punosh edhe vitin e ardhshëm, ty do të zbriten 5.3% nga paga. Nga këto 5.3 pjesa me e madhe shkon për AHV/AVS e një pjesë e vogël për sigurimin e invaliditetit IV/AI si dhe për rregulloren e zëvendësimit të të ardhurave për shërbimin ushtarak, shërbim civil, lehoni e atësi (EO/APG).

Kontributet për arkën pensionale do të zbriten nga 1 janari pas mbushjes së moshës 17 vjeç. Në të kundërtën e AHV/AVS për arkën pensionale në të vërtetë paguhet kontributet vetëm nëse të ardhurat kalojnë shumë prej 21510 frangave. Kjo shumë zor se arrihet tek puna gjatë pushimeve.

(Work, 21.10.22)

Pensioni i vejërisë: E i lejohet AHV/AVS të shlyej pensionin tim?

Unë jam një burrë 50 vjeç dhe kam një djalë dhe një vajzë. Djali im është 23 vjeç ndërsa vajza 18 vjeçe në vitin e tretë të mësimin të profesionit. Para katër vitesh bashkëshortja ime ka humbur jetën në një aksident komunikacioni. Nga ajo kohë unë nga AHV/AVS marr një pension vejërie dhe për vajzën time një pension jetimësh. Pensioni i jetimëve për djalin tim është shlyer, pasi që ai ka përfunduar arsimimin profesional. Para një kohe të shkurtër AHV/AVS ma ka komunikuar se më nuk do të ma paguaj pensionin e vejërisë, pasi që vajza ime do të mbush moshën madhore. Mirëpo, pensioni i jetimëve për vajzën time do të vlejë më tej. A i lejohet AHV/AVS, që thjeshtë, të shlyej pensionin tim të vejërisë?

David Aeby: Jo. Edhe pse në nenin 24 të ligjit të AHV/AVS qëndron, që një burrë i vejërie do të merr pensionin e vejërisë, deri në mbushjen e moshës madhore të fëmijës më të vogël. Mirëpo, një vendim i plotfuqishëm i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, tanimë ka ndryshuar këtë rregull. Tani personat e vejërie duke u thirrur në rregullat e barabarta, të cilat kanë vlejtur vetëm për gratë e veja. Kjo domethënë: Pensioni i vejërisë nuk do të shlyhet, nëse fëmija mbush moshën madhore. Dhe nëse personat e vejërie në kohën e ndodhjes së vdekjes së bashkëshortit/es kanë qenë në moshën 45 vjeç e më shumë dhe nëse bashkëshortësia ka zgjatuar më shumë se 5 vite, do të marrin një pension vejërie, edhe atëherë kur nuk kanë fëmijë fare. Personat e vejërie në Zvicër, qofshin gra apo burra, bazuar në kushtet e barabarta menjëherë mund të kërkojnë pensionin

(Work, 21.10.22)

Të dashur/a lexues/e të Horizonte: Gëzaur festat e fundvitit dhe gjitha të mirat për vitin e ri 2023!

Lëvizja e lirë e personave: Nga 1 janari 2023 kufizime për Kroacinë

Qeveria federale aktivizon klauzolën mbrojtëse karshi Kroacisë

Në vitin 2023 do të futen prapë kontingjentet dhe kështu qasja e punëmarrësve nga Kroacia në tregun zviceran të punës përsëri do të kufizohet. Numri i punëmarrësve nga Kroacia në vitin që po lëmi është rritur dukshëm dhe sipas vendimit të Qeverisë federale të Zvicrës ka tejkaluar pragu i përcaktuar në Marrëveshjen për lëvizje të lirë të personave (FZA/l'ALCP).

Darinka Filipovic

Qeveria federale në mbledhjen e saj të 16 nëntorit 2022 ka vendosur që të zbatojë për Kroacinë klauzolën e paraparë të Marrëveshjes për lëvizje të lirë të personave me BE-në. Marrëveshja në fjalë është në fuqi që nga 1 janari 2017 dhe gjatë kohë kalimtare 10 vjeçare parashihet një hapje të qasjes së shtetasve kroat në tregun zviceran të punës hap pas hapi.

Lëvizja e plotë e lirë me Kroacinë zgjati vetëm 1 vit

Që nga 1 janari 2022 vlen lëvizja e lirë e plotë për Kroacinë. Mirëpo, kjo zgjati vetëm 1 vit. Nga 1 janari 2023 klauzola e Marrëveshjes për lëvizje të lirë lejon që për një kohë të kufizuar të futen leje të njëanshme kontingjentesh, nëse migrimet nga Kroacia tejkalojnë vlerën e caktuar. Ky prag është arritur, nëse numri i lejeve të dhëna

(2022) është 10% mbi mesataren e tri viteve të fundit (2019–2021). Mes janarit dhe tetorit të vitit 2022, Zvicra ka nda 2413 leje B për fuqi punëtore kroate, ndërsa pragu i tërësishtëm për gjithë vitin 2022 do të duhej të ishte 178 (në vitet 2019–2021 sipas shifrave të zbatueshme mesatare numri i lejeve të leshura B është 162, +10%). Për këtë arsye, Zvicra nga 1 janari 2023 do të fusë përsëri kontingjentet e lejeve B deh L. Për vitin 2023 për punëmarrësit nga Kroacia janë 1150 leje të reja B dhe 1007 leje të reja L në dispozicion.

Masat e parapara në Marrëveshjen për lëvizje të lirë

Qeveria federale vendimin e saj kufizues për shtetasit e Kroacisë e arsyeton si pasojë të krizës së Covid-19. Gjithashtu është rritur edhe numri i lejeve për shtetasit e Kroacisë dhe ka tejkaluar pragun e paraparë me Marrëveshjen për lëvizje të lirë.

Fuqia punëtore e Kroacisë ishte e kërkuar parasëgjithash në sektorin sekondar, ndërsa në atë terciar veçanërisht në gastronomi, tregti dhe në ndërmjetësim të punës. Mirëpo, një rritje për fuqinë punëtore kroate është shënuar edhe në sektorët me kualifikime të larta si planifikimi, këshillimi dhe shërbimet e informatikës.

Menaxhimi i migracionit sipas nevojave ekonomike

Qeveria federale përdor instrumentet që ka në dispozicion për të menaxhuar më mirë migracionin në përputhje me nevojat ekonomike. Në të kaluarën Zvicra edhe karshi shtetasve tjerë, të cilët iu kanë bashkuar BE-së, në mënyrë të përsëritur ka përdorur klauzolën mbrojtëse. Përmes përdorimit të masës mbrojtëse, ajo kujdeset për një zbatim hap pas hapi të lëvizjes së lirë për shtetasit e Kroacisë në tregun zviceran të punës.



Përfshirja në vend të prekalizimit

Kundër diskriminimit dhe prekalizimit në rritje të migrantëve

Përse migrantët janë të prekur mbi mesataren prej prekalizimit dhe të konfrontuar më së shumti nga varfëria e punësimit? Dhe kjo pikërisht në një vend të pasur, i cili është krenar për sistemin e vet të sigurimeve shoqërore.

Laura Marioli

Kushdo që mendon se të gjithë në Zvicër trajtohen në mënyrë të barabartë nga rrjeti ynë mbështetës, gabohet. Strukturat tona nuk janë aspak solidare dhe pamjaftueshëm të rrjetëzuara. Ato dëshmojnë boshllëqe. Në këto boshllëqe bien veçanërisht migrantët, njerëzit e racizuar, njerëzit pa status të rregullt qëndrimi dhe ata pa pasaportë zvicerane.

Në dy kontribute trajtuese të Komisionit Federal kundër Racizmit dhe Komisionit Federal të Migracionit, Hilmi Gashi dhe Marie Saulnier Bloch vejnë në pah shkaqet e ndryshme të këtij deficiti dhe ofrojnë perspektiva sindikaliste për veprim. Që të dy bëjnë të qartë se situata gjithnjë e më e pasigurt e njerëzve pa pasaportë zvicerane dhe diskriminimi i shumëfishtë ndaj të cilit ata janë të ekspozuar janë të lidhura dhe të varura në mënyrë të ndërsjellët.

Strukturat e Zvicrës favorizojnë shoqërinë dy klasash. Njëra mbrohet nga varfëria, tjetra kriminalizohet pse është e varfër. Kjo është diskriminuese dhe ndër të tjera ndikon që të prekurit të mos drejtohen tek qendrat sociale, nga frika se do të rrezikojnë sigurinë e qëndrimit të tyre në Zvicër. Kjo nga ana tjetër i vendos ata në një pozitë edhe më të cënueshme në tregun e punës dhe i bën ata më të prekshëm ndaj dumpingut të pagave. Shumica e tyre nuk arrijë të dalin kurrë nga ky rreth vicioz.

Sikur dëshmojnë të dy kontributet trajtuese, diskriminimi në Zvicër ndodh në rrafshin institucional, shoqëror dhe individual. Njerëzit, të cilët janë të prekur nga kjo, shpesh tërhiqen dhe nuk janë të dukshëm në shoqëri. Është përgjegjësi i jona kolektive, të luftojmë këtë diskriminim të pandërprerë.

Tangram: <https://bit.ly/3EVEZ4i>

Terra Cognita: <https://bit.ly/3AK4hzY> (faqe 98-100)